



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01-006-26348 të datës 30 mars 2016, neneve 14, dhe 19 parag. 1.11 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, sipas kërkesës me nr.228/18 datë 14 nëntor 2018 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2018, miratoi,

VENDIM

PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përhershëm përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për periudhën deri më 31 dhjetor 2020

Neni 2

1. Për çdo person të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja, bëhet subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Bashkësia Islame përkatësisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, që përfshijnë: transportin e kufomës, fletëlajmrimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefinin.

2. Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimore, i bashkëngjit edhe konstatimin e vdekjes nga mjeku, dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar – nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja ose numri i letërnjoftimi).

Neni 3

Autorizohet Kryetar i Komunës, të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, në cilësinë e subjektit të vetëm për ofrimin e shërbimeve sipas këtij vendimi, përmes së cilës definoohen më në detaje obligimet dhe përgjegjësitë.

Neni 4

Subvencionimi bëhet nga mjetet buxhetore përkatësisht të hyrat vetanake – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është çmimorja e shërbimeve.

Neni 6

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorinë e Administratës.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ndërsa fillon të zbatohet nga 01 janar 2019.

Nr. 01-454/01-0093076/18
Podujevë,
30 nëntor 2018



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi